



---

**“ILLYRIAN GUARD” SH.A**

**Miratohet**

**ADMINISTRATORI**

**Robert LILI**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, me \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2022

**PROCES VERBAL datë \_\_.\_\_.2022**

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**“Blerje Pajisjesh Kompjuterike”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

- **Pajisje kompjuterike dhe furnizime – 30237200-1.**

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 7.977.781 (shtatë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tetdhjetë e një lekë).

- Sigurimi i ofertës 2% e fondit limit sipas nenit 30, pika 3, tw VKM nr.285, datë 19.05.2021. **159.555.62** (njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë pik gjashtëdhjetë e dy) lek

Në bazë të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 21, pika 2,

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria “Illyrian Guard” ShA** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 ne masen 2% te fondit limit;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 8.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të lëshuar nga Administrata Tatimore për vitet financiare (2019-2020-2021), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, të jetë jo më e vogël se 20% e vlerës së fondit limit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe dhe nenit 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

## 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

**2.3.1** Dëshmi për furnizime të mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të fondit limit të kontratës që prokurohet.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme, operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë:

- Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me një Ent Publik, Autoriteti Kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik dhe fatura tatimore të shitjes të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën dhe faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitetet e duhura për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

**2.3.2.** Operatori ekonomik duhet të ketë certifikimet ISO brënda afatit të vlefshmërisë si më poshtë:

- ISO 9001, për menaxhimin e cilësise
- ISO 27001, për menaxhimin e sigurisë së informacionit
- ISO 20000-1 për menaxhimin e shërbimeve IT

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 dhe 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) dhe nenit 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/çertifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar me sukses kontratën.

Nisur nga proceset e punës dhe shërbimeve që ai ofron, gjykohet e arsyeshme që operatori ekonomik proceset e punës së tij, ti bazojë në standarde botërore, të cilat në mënyre direkte ndikojne në cilësi, shpejtësi, efikasitet dhe të shërbimeve të ofruara.

Sistemi i menaxhimit të cilësisë siguron që operatori ekonomik zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë të kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilësor të tij.

Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit siguron që operatori ekonomik aplikon, mirëmban dhe përmirëson në mënyrë të vazhdueshme një përjasje sistematike në menaxhimin e informacionit sensitiv me fokus tek siguria.

Sistemi i menaxhimit të shërbimeve të IT konfirmon angazhimin e operatorit ekonomik për të ofruar dhe përmirësuar vazhdimisht cilësinë e shërbimeve. ISO 20000-1 është standardi ndërkombëtar për Menaxhimin e Shërbimit të Teknologjisë së Informacionit (ITSM) i pranuar nga shumica e vendeve të botës. Standardi përshkruan një seri procesesh menaxhimi të krijuara për të ndihmuar kompanitë të ofrojnë shërbime më efektive të IT (si për ato brenda kompanisë ashtu edhe për klientët e tyre), i cili jep metodologjinë dhe kornizën për të ndihmuar kompanitë të menaxhojnë ITSM. Me kërkesat e standardit kompanitë aplikojnë praktikatat më të mira, duke ndihmuar në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve IT.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi, ose autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, i cili duhet të përfshijë mallrat objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Secili nga dokumentat e paraqitur duhet të përmbajë të dhënat e plota të prodhuesit, adresën e saktë dhe kontaktet e prodhuesit.

**Argumentimi:** Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalën zyrtar të origjinës së mallrave/licensimeve specifike që kërkohen në këtë prokurim, na garanton gjithashtu se ofertuesi është i autorizuar edhe nga pikëpamja territoriale (pra për Shqipërinë) për ofrimin tek AK të këtyre produkteve. Kjo garanci lidhet njëkohësisht me treguesit cilësorë të produkteve që kërkohen të blihen e që janë prodhuar/krijuar sipas standardeve më të larta nga prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe

përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë shitëse dhe teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës duke vertetuar se disponojnë autorizimet përkatëse për furnizimin e produkteve, objekt i kontratës, të lëshuara nga prodhuesit/distributorët përkatës si dhe që do vijnë për të zbatuar kushtet e garancisë. Autorizimet e Prodhuesit/Distributorit nga prodhuesit/distributorët të kanalit zyrtar përkatës me qëllim që të garantojnë Autoritetin Kontraktor se këta operatorë ekonomike kanë të drejta për të rishitur këto produkte, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e procesit nga të njëjtët prodhues.

Ky kriter është përcaktuar në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë se mallrat objekt prokurimi që do të ofertojë janë të reja.

**Argumentimi:** Ky kriter është përcaktuar në mënyrë që AK të ketë garanci që operatori ekonomik ofertues do të paraqesë mallrat objekt prokurimi në cilësinë e kërkuar nga AK, dhe në mbështetje të pikës 8 të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë (në mënyrë elektronike, në sistemin e APP-së) katalog për mallrat që oferton, të përkthyer në gjuhën shqipe, të markuar secilin nga artikujt e ofertuar dhe të noterizuar, në mënyrë që të vërtetohet përputhja me specifikimet teknike të dokumentave të tenderit të autoritetit kontraktor.

**Argumentimi:** Ky kriter është përcaktuar në mënyrë që AK të ketë garanci që operatori ekonomik ofertues do të paraqesë mallrat objekt prokurimi në cilësinë e kërkuar nga AK, dhe në mbështetje të pikës 6 të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë ku të përcaktojë se mallrat objekt prokurimi që do të ofertojë kanë vite garanci përdorimi aq sa është e përcaktuar nga AK tek specifikimet teknike bashkelidhur.

**Argumentimi:** Ky kriter është përcaktuar në mënyrë që AK të ketë garanci që operatori ekonomik ofertues do të paraqesë mallrat objekt prokurimi në cilësinë e kërkuar nga AK, dhe në mbështetje të pikës 8 të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë ku të deklarojë që do të marrë përsipër montimin, instalimin, konfigurimin e mallrave.

**Argumentimi:** Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të pikës 8 të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të ketë një numër prej minimalisht 4 (katër) punonjës teknik të siguruar, ky personel teknik që do të angazhohen në montim/instalim të pajisjeve të ofertuara.

a) Të paktën 2 (dy) specialistë, të çertifikuar në nivel teknik për instalimin dhe konfigurimin e pajisjeve kompjuterike/informatike “CompTIA IT Operations Specialist”, ose ekuivalent.

b) Të paktën 2 (dy) specialistë, të çertifikuar në nivel teknik për instalimin dhe konfigurimin e pajisjeve të rrjetit “CompTIA network infrastructure professional”, ose ekuivalent.

Për të vërtetuar stafin e mësipërm operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Certifikata përkatëse
- Listëpagesat sipas formularit E-Sig. 025/a për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruara sipas legjislacionit në fuqi.

Kërkesat e mësipërme duhet të vërtetohen me: Certifikatat përkatëse.

Argumentimi

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht:

1. Për kriterin në pikën a), duke qenë se objekt i procedurës së prokurimit janë furnizimi dhe vendosja e pajisjeve kompjuterike, është gjykuar e nevojshme që Operatori Ekonomik të ketë në stafin e tij të paktën 2 (dy) specialist të çertifikuar në nivel teknik pajisjesh kompjuterike “CompTIA IT Operations Specialist” për të mundur instalimin dhe me funksionalitet të plotë të tyre dhe njëkohësisht të sigurojë suport gjatë kohëzgjatjes së garancisë të produkteve.

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

**Njesia e Prokurimit**